

**FEDERATA E PINGPONGUT TË
KOSOVËS (FPPK)**

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E PËRFUNDUAR
MË 31 DHJETOR 2021**

PËRMBAJTJA

	Faqe
Përmbajtja	2
Shkurtesat	3
Informatat e përgjithshme	4
Raporti i auditorit të pavarur	5-6
Pasqyra e pozicionit financiar	7
Pasqyra e të hyrave gjithëpërfshirëse	8
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	9
Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare	10
Shënimet e pasqyrave financiare	11-21

Shkurtesat e përdorura

SNA-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

SNK-Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit

SKK-Standardet Kosovare të Kontabilitetit

SNRF-Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

MKRS - Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve të Kosovës

ITTF - Federata Ndërkombëtare e Pingpongut

ETTU - Unioni Evropian i Pingpongut

BTTU - Unioni Ballkanik i Pingpongut

MTTU – Unioni Mesdhetar i Pingpongut

KOK - Komiteti Olimpik i Kosovës

Informatat e përgjithshme

Bordi ekzekutiv:

Jeton Beqiri, Kryetar

Jeton Oruqi, nënkryetar

Linda Zeqiri, nënkryetare

Besim Hajdari, nënkryetar

Besnik Behluli, anëtar

Edona Shabani, anëtare

Feim Rama, anëtar

Qamil Vishaj, anëtar

Ridvan Hashani, anëtar

Gresa Bakraqi, anëtare

Blerina Boshnjaku, anëtare

Sekretar i përgjithshëm i Federatës

Fadil Luta,

Zyra e regjistruar:

Shtëpinë e Sporteve
Rr. Agim Ramadani, nr. 43, zyra nr. 7
10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

Bankat:

Banka për Biznes, filiali Prishtinë

Auditor:

Qerim Qerimi – Auditor Ligjor
Rruga Astrit Bytyqi - Ferizaj
Republika e Kosovës,
Kontakti:
qerim_qerimi.aud@hotmail.com
+383 49 100030
+383 44 323802

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për: Bordin dhe Menaxhmentin e Federatës së Pingpongut të Kosovës

Opinionit I pakualifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Federatës së Pingpongut të Kosovës (FPPK), që përfshinë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2021, Pasqyrën e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e Ndryshimeve në Ekuitet dhe Pasqyrën e Rrjedhës së Parasë së Gatshme për vitin që ka përfunduar, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për), pozicionin financiar të Federatës me datën 31 Dhjetor 2021, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me *Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël* të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (*Kodi i BSNEPK*) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në *[juridiksionin]*, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të43, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreze, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezultojnë nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktoj procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllim të shprehjes së një opinion mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpjegimeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marre, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarje ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshimet e mëdha për aftësinë e Kompanisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet të ardhshme mund të bëjnë që Kompania të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to, në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar me qeverisjen e Federatës, përveç tjerave lidhur me qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të kemi identifikuar gjatë auditimit.

Qerim Qerimi - Auditor Ligjor



vv

Data e raportit: 07.03.2022


Federata e Pingpongut te Kosovës
Pasqyrat financiare, për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor 2021

Pasqyra e Pozitës Financiare
Më 31 dhjetor 2021

	Shënime	31 dhjetor 2021 (në EUR)	31 dhjetor 2020 (në EUR)
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtëra			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	3	24,120	11,352
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	4	-	46,480
Pasuritë tjera afatshkurtëra		-	-
Gjithësej pasuritë afatshkurtëra		24,120	57,832
Pasuritë afatgjata			
Prona dhe pajisje	5	2,788	3,566
Pasuritë tjera afatgjata		-	-
Gjithësej pasuritë		2,788	3,566
GJITHËSEJ PASURITË		26,908	61,398
DETYRIMET			
Detyrimet Afatshkurtëra			
Kreditë dhe Huatë		-	-
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	6	3,107	19,549
Detyrimet tjera afatshkurtëra		-	-
Gjithësej detyrimet afatshkurtëra		3,107	19,549
Detyrimet Afatgjata			
Kreditë dhe huatë , pjesa afatgjate		-	-
Detyrime tjera afatgjate		-	-
Gjithësej detyrimet afatgjata		-	-
GJITHSEJ DETYRIMET		3,107	19,549
EKUITETI			
Fondi i bartur me 01.01	7	41,849	(3,521)
Teprica/mungesa e fondit		(18,048)	45,369
Gjithësej ekuiteti		23,801	41,849
Gjithësej detyrimet dhe ekuiteti		26,908	61,398

Këto pasqyra financiare u aprovuan dhe nënshkruan me datë 26 Shkurt 2022 ne emër të FPPK-së nga:

Jeton Beqiri
Kryetari i FPPK




Fadil Luta
Udhëheqësi financiar



Shënimet nga 11 deri 21 janë pjesë përbërëse e këtyre Pasqyrave Financiare.

Federata e Pingpongut te Kosovës
Pasqyrat financiare, për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor 2021

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithpërfshirëse
Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
		(në EUR)	(në EUR)
TË HYRAT			
Të Hyrat për projekte	8	80,140	149,114
Të hyrat tjera		1,179	-
Gjithsej të hyrat		81,318	149,114
SHPENZIMET			
Shpenzimet programore	9	(71,818)	(62,924)
Shpenzimet e zhvlerësimit	5	(1,058)	(1,073)
Shpenzime të tjera operative	9	(26,490)	(39,748)
Teprica/Ulja operative		(18,048)	45,369
Të ardhura financiare		-	-
Shpenzime financiare		-	-
Teprica/Ulja e vitit		(18,048)	45,369

Shënimet nga 11 deri 21 janë pjesë përbërëse e këtyre Pasqyrave Financiare.

Federata e Pingpongut te Kosovës
Pasqyrat financiare, për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor 2021

Pasqyra e ndryshimeve në fonde
Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021

	Tepricat/(Uljet) e Mbajtura (në EUR)	Rezervat e tjera (në EUR)	Gjithësej (në EUR)
Pozicioni financiar më 1 janar 2020	(3,521)	-	(3,521)
Teprica/Mungesa i/e vitit	45,369	-	45,369
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	41,849	-	41,849
Teprica/Mungesa i/e vitit	(18,048)	-	(18,048)
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2021	23,801	-	23,801

Shënimet nga 11 deri 21 janë pjesë përbërëse e këtyre Pasqyrave Financiare.

Federata e Pingpongut te Kosovës
Pasqyrat financiare, për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor 2021

Pasqyra e flukseve monetare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
<i>Rrjedhja e parasë nga aktivitete operative</i>		
Fitimi/Humbja para tatimit	(18,048)	45,369
Axhustime për zërat jo-monetare:		
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	1,058	1,073
Amortizimi i pasurive të paprekshme	-	-
Fitim nga shitja e pronave dhe pajisjeve	-	-
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	(16,990)	46,442
<i>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet</i>		
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	46,480	(17,754)
Pasuritë tjera afatshkurtëra	-	-
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	(16,442)	(18,034)
Detyrimet tjera afatshkurtëra	-	-
Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet operative	30,038	(35,788)
<i>Rrjedhja e parasë nga aktivitetet investuese</i>		
Pagesat për blerjet e pronës dhe pajisjeve	(280)	(440)
Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme	-	-
Arkëtimet nga shitja e pronës, pajisjeve dhe impianteve	-	-
Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet investuese	(280)	(440)
<i>Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese</i>		
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë	-	-
Ripagimi i kredive dhe huave	-	-
Pagesat tjera financiare	-	-
Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet financuese	-	-
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të saj	12,768	10,214
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	11,352	1,138
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	24,120	11,352

3

Shënimet nga 11 deri 21 janë pjesë përbërëse e këtyre Pasqyrave Financiare.

1. Hyrje

a) Korniza ligjore

Federata e Pingpongut të Kosovës (FPPK) është regjistruar pranë Qendrës për themelimin e OJQ-ve në Prishtinë me 18/12/2000, me NRB 5100503-1.

Federata e Pingpongut të Kosovës, është themeluar konform rregullave të nenit 2.2 të Rregullores nr. 1999/22 të cilat janë zëvendësuar me: Ligjin Nr. 03/L-134 Për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare dhe Ligjin nr. 04/L-57 Për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare. FPPK është organizatë joqeveritare dhe jo profitabile.

Në përputhje me rregullat e nenit 4 të Ligjin nr.03/L-57 Për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, nuk shpërndan të ardhura neto ose fitime për asnjë person. Pasuritë, të ardhurat dhe fitimet e saja përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse. Po ashtu nuk përdoren për të sjellë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi përfitime, për ndonjë themelues, drejtor, nëpunës, anëtar, punonjës ose donator të Qendrës. Mirëpo nuk pengon pagesën a kompensimin e arsyeshëm për personat që e kryejnë punën për qendrën.

b) Statuti

FPPK, veprimtarinë e vet e ka të rregulluar sipas Statutit të cilin e ka aprovuar me datën 03.09.2011, e përmirësuar me datë 11.02.2020.

Rregullat e këtij statuti përshkruajnë se:

- FPPK të quhet Federata e Pingpongut e Kosovës (neni 8).
- FPPK është Shoqatë jofitimprurëse (neni 6 pika 3).
- FPPK nuk do të shpërndajë çfarëdo fitimi neto ose të profitit si të tillë për asnjë individ (neni 17).

• Themelues të FPPK janë: Klubet e pingpongut

- Përfaqësues i autorizuar i FPPK është: Kryetari Jeton Beqiri, Prishtinë, Kosovë (neni 11).

FPPK është organizatë sportive e pavarur, joqeveritare përmes së cilës realizohen caqet e përbashkëta dhe detyrat e zhvillimit dhe përparimit të sportit të pingpongut në Republikën e Kosovës (neni 3).

FPPK është e fokusuar në këto aktivitete:

- Zhvillimi i sportit të Pingpongut në Kosovë,
- Përcaktimi dhe zbatimi i politikave zhvillimore të sportit të Pingpongut,
- Harmonizimi i aktiviteteve të klubeve, shkollave dhe seksioneve të Pingpongut,
- Propozimi i programeve të aktiviteteve të Pingpongut si nevoja publike,
- Mbështetja në realizimin e programeve publike në sportin e Pingpongut,
- Përcaktimi i politikës për mbrojtjen e cilësisë kulmore/ të lartë të sportistëve,
- Mbështetja e punës profesionale dhe aftësimi i personelit profesional të sportit të Pingpongut,
- Mbështetja për kushtet e përgatitjeve të sportistëve kulmor për Lojërat Olimpike, Kampionatet Evropiane dhe Botërore dhe garat tjera ndërkombëtare,

- Përcaktimi i formës së garave dhe kushteve të organizimit të garave në Pingpong,
- Mbështetja në sigurimin e mjeteve për sigurimin e aktiviteteve afariste dhe të tjera.

- Anëtarët e FPPK-së janë klubet e Pingpongut (private dhe publike) që veprojnë në Republikën e Kosovës (neni 18).
- Kuvendi i FPPK-së (ne tekstin e mëtejme: Kuvendi) është organi më i lartë i FPPK-së i cili drejton punën e FPPK-së.
- Kuvendi zgjedhë Organet dhe Komisionet e veta (neni 28).
- FPPK ndërpret punën në pajtueshmëri me dispozitat ligjore ose kur Kuvendi vendos me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit (neni 80).
- Bordi i FPPK-së, miraton planin financiar dhe llogarinë përfundimtare dhe ia dërgon Kuvendit për miratim (neni 9.1).

Paraqitja e pasqyrave financiare për vitin i cili ka përfunduar më 31 dhjetor 2021 është bërë më 30 Mars 2021, sipas autorizimit nga Sekretari i përgjithshëm.

2. Përmbledhja e politikave domethënëse të kontabilitetit

2.1 Përmbledhje

Federata e Pingpongut e Kosovës (në tekstin e mëtejme: FPPK) është organizatë sportive e pavarur, joqeveritare përmes së cilës realizohen caqet e përbashkëta dhe detyrat e zhvillimit dhe përparimit të sportit të pingpongut në Republikën e Kosovës.

2.2 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare të FPPK-së janë përgatitur nga të gjitha aspektet materiale në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), të cilat i përfshijnë standardet dhe interpretimet e miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit si dhe interpretimet nga Komisioni Ndërkombëtar për Interpretimin e Raportimit Financiar të miratuara nga Komisioni i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (KSNK) të cilat janë në fuqi.

Pasqyrat financiare janë përgatitur për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2021

Të dhënat rrjedhëse dhe ato komparative janë vlerësuar dhe janë paraqitur në njësinë monetare “euro”, përveç nëse kërkohet ndryshe.

2.3 Vazhdimi i aktiviteteve

Aftësia e FPPK për t'i përmbushur obligimet e saja sipas gjendjes momentale dhe pohimeve të BORDIT është e qëndrueshme.

Pasqyrat financiare të Federatës janë, përgatitur sipas parimit që OJQ-ja ka vazhduar me aktivitetin e saj deri më 31 dhjetor 2021, si dhe do të vazhdojë deri në kohën e paraqitjes së pasqyrave financiare për vitet pasuese.

2.4 Shfrytëzimi i përllogaritjeve (vlerësimet e përafërta)

Përgatitja e pasqyrave financiare në pajtim me SNRF-në, kërkon nga BORDI që t'i kalkulojë dhe t'i supozojë ashtu që të ndikojnë në shumat e raportuara të pasurive dhe të detyrimeve (obligimeve) dhe paraqitjen e pasurive kontingjente (të jashtëzakonshme) dhe detyrimeve në ditën e paraqitjes së pasqyrave financiare si dhe të shumave të raportuara për të ardhurat dhe shpenzimet gjatë periudhës së raportimit.

Rezultatet e tanishme nuk parashihet të ndryshojnë nga ato të përllogaritura.

2. Përmbledhja e politikave të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

2.5 Inventari, Pajisjet dhe Veturat

Pasuritë janë bartur gjatë vlerësimit, që determinohet si në vijim:

Për pasuritë e fituara nga donacionet për Federatën që nga themelimi pra në vitin 1953 e deri më tani, zërat e pajisjeve janë marrë me çmim kushtues duke zbritur cilindo zhvlerësim pasues të akumuluar dhe cilëndo humbje pasuese nga dëmet.

Vlerësimin në tërësi të inventarit, pajisjes dhe të veturave.

Vlerat që e bartin inventari, pajisja dhe veturat, janë shqyrtuar për shkak të dëmeve, kur ngjarjet ndryshojnë ose kur rrethanat e ndryshuara tregojnë që vlera bartëse mund të mos jetë e riparueshme. Nëse ekzistojnë tregues të këtillë dhe kur vlerat bartëse e tejkalojnë shumën e përllogaritur të riparimit, këto pasuri ose njësitë monetare në qarkullim janë regjistruar në shumën e tyre të riparueshme.

Gjatë përcaktimit të vlerës përdoruese, rrjedhjet e përllogaritura të parasë së gatshme në të ardhmen zbriten deri në vlerën e tyre të tanishme, duke zbatuar përqindjen e skontimit para zbritjes së tatimit që i reflekton vlerësimet e tanishme të tregut të vlerës në kohë të parasë si dhe rreziqet specifike për pasuritë (mjetet). Për një mjet (pasuri) që në masë të madhe vetvetiu nuk i vë në qarkullim rrjedhjet e parasë, shuma e riparueshme përcaktohet për njësinë monetare në qarkullim të cilës i përkasin pasuritë. Humbjet nga dëmet, regjistrohen në bilancit e suksesit.

Zhvlerësimi llogaritet sipas metodës lineare dhe në pajtim me shkallët e përcaktuara si në vijim:

Ndërtesat	5%
Makina dhe pajisje	20%
Automjete	20%
Kompjuterë	20%

2.6 Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e parasë

Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë paratë në bankë dhe paratë e gatshme në arkë.

2.7 Përfitimet e punonjësit

FPPK nuk i kontribuon planeve të periudhës pas pensionimit të punonjësve të saj, ashtu siç është përshkruar nga legjislacioni i Republikës së Kosovës për sigurimin social.

Kontributet në bazë të pagave, janë bërë për organizatat vendore, të cilat janë përgjegjëse për pagimin e pensioneve. Nuk ka përgjegjësi tjetër lidhur me këto plane dhe si të tilla këto skema konsiderohen si plane të përkufizuara për kontribute.

FPPK nuk përfiton nga punonjësit e saj pas periudhës së pensionimit.

2.8 Tatimi

Pasi që është themelatë jofitimprurëse dhe OJQ me status të përfituesit publik edhe nëse realizon të ardhura neto nuk i nënshtrohet obligimeve tatimore për tatimin në profit (pika 4 e nenit 17 të Ligjit nr. 03/L-057 Për Lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare si dhe nenit 7 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-029 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave.

2.9 Instrumentet financiare

Pasuritë dhe detyrimet financiare të paraqitura në bilancin e gjendjes përfshijnë: Paranë e gatshme si dhe ekuivalentët e parasë.

Politikat e kontabilitetit lidhur me futjen dhe vlerësimin e këtyre zërave janë të njohura (publike) në politikat përkatëse të kontabilitetit të përfshira në këtë shkresë. Instrumentet financiare janë klasifikuar si pasuri (mjete), detyrime ose kapital në pajtim me përmbajtjen e marrëveshjes kontraktuese.

Fitimet dhe humbjet lidhur me instrumentet financiare janë të klasifikuara si pasuri ose detyrime janë raportuar si të hyra, përkatësisht si shpenzime. Instrumentet financiare kompensohen kur shoqata ka të drejtën ligjore të zbatueshme për të kompensuar dhe synon që këtë ta shlyej, qoftë sipas madhësisë neto ose ta realizojë mjetin dhe njëkohësisht ta shlyej detyrimin.

2.10 Provizionet dhe kontingjentet

Provizionet merren kur FPPK tashmë ka një obligim ligjor si rezultat i një gjendjeje të mëparshme dhe ka mundësi që rrjedhja e burimeve e cila i materializon përfitimet ekonomike të kërkojë shlyerjen e obligimit si dhe një përlllogaritje të besueshme mund të bëhet në shumën e atij obligimi. Provizionet rishikohen në çdo bilanc të gjendjes dhe korrigjohen për të pasqyruar vlerën e tanishme të shpenzimeve të cilat priten të shkaktohen për ta shlyer obligimin.

2.11 Shëndërrimi në valutë të huaj

Vlerësimi dhe paraqitja e Pasqyrave Financiare të qendrës bëhet në valutën euro. Transaksionet të cilat i përfshijnë valuat e huaja regjistrohen sipas kursit i cili ekziston në ditën e transaksionit. Pasuritë monetare (nominale) dhe obligimet të denominuara në valuta të huaja vlerësohen sipas kursit të këmbimit i cili ekziston në ditën e bilancit të gjendjes. Diferencat që rezultojnë nga shkëmbimi, janë paraqitur në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave.

2.12 Vlerësimi i të ardhurave

Të ardhurat janë fituar nga donatorët jashtë Kosovës të cilat donacione kanë qenë: nga qeveritë dhe nga Shoqëria civile.

I.PASQYRA E BILANCIT**3. Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme**

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Paratë e gatshme	4.55	13.40
Paraja në bankë	24,115.60	11,338.65
Gjithësej	24,120.15	11,352.05

Paraja e gatshme tek bankat realizon fitim nga kamata në shkallët fikse dhe e cila kamatë përcaktohet nga secila bankë në mënyrë individuale si dhe mund të ndryshohet me vendimin e tyre. Këto mjete janë në llogarinë bankare BPB.

4. Kërkesat dhe Parapagimet

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Llogaritë e Arkëtueshme/Kërkesat	-	46,480.00
Gjithësej	-	46,480.00

4.1 Shpalosja e kërkesave/të arkëtueshmeve

Departamenti kësti III dhe IV

- 46,480.00

Federata e Pingpongut te Kosovës

Shënimet për pasqyrat financiare, për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor 2021

5. Prona dhe pajisje

	Pajisje dhe Makineri	Ndertesa	Totali
Kosto			
Gjendja më 1 janar 2020	4,923.83	-	4,923.83
Shtesa	440.00	-	440.00
Transferime	-	-	-
Pakësime	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	5,363.83	-	5,363.83
Shtesa	280.00	-	280.00
Transferime(shitje)	-	-	-
Pakësime	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2021	5,643.83	-	5,643.83
Amortizimi i akumuluar			
Gjendja më 1 janar 2020	725.23	-	725.23
Zhvlerësimi i vitit	1,072.77	-	1,072.77
Kthim amortizimi	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	1,798.00	-	1,798.00
Zhvlerësimi i vitit	1,058.00	-	1,058.00
Pakësime	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2021	2,856.00	-	2,856.00
Vlera neto kontabël			
Gjendja më 31 dhjetor 2020	3,565.83	-	3,565.83
Gjendja më 31 dhjetor 2021	2,787.83	-	2,787.83

Federata e Pingpongut te Kosovës**Shënimet për pasqyrat financiare, për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor 2021****6. Llogaritë e pagueshme tregtare**

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Llogaritë e pagueshme tregtare	3,107.11	19,549.18
Gjithësej	3,107.11	19,549.18

Llogaritë e pagueshme ju përkasin obligimeve që FPPK ka ndaj bashkëpunetorëve që kanë ndihmuar në përmbyllje të projekteve, e pritët ti shlyejë këto obligime në periudhën në vijim. Obligimet ju përkasin këtyre anëtarëve:

N.R.	Huadhënësi / Furnitori / Paga	2021	2020
1.	Pagat dhe medijtjet	2,951.61	5,085.00
2.	Furnitorët / Huazimet	30.50	14,464.18
3.	Rimbursimet	125.00	-
Gjithsejte:		3,107.11	19,549.18

Të hyrat e shtyra janë determinuar sipas kriterit të efektit të kompetencës së përkohshme të vitit. Për një periudhë kohore janë verifikuar kushtet që çuan në regjistrimin e tyre origjinal, miratimit, nëse është e nevojshme, të variacioneve (ndryshimeve) të duhura.

Për ushtrimin nën auditim, të hyrat e shtyra janë zëri kryesor i obligimeve në Pasqyrën e pozicionit financiar. Këto të hyra ju përkasin obligimeve që ka FPPK për periudhat vijuese për ushtrimin e aktiviteteve të saja normale. Njihen në Pasqyrën e të ardhurave në baza sistematike në të njëjtat periudha në të cilat njihen shpenzimet.

Të hyrat e shtyra janë obligime për projektet të cilat FPPK, do ti përfundojë, projektet këto te filluara më parë dhe do ti përfundojë në periudhat në vijim për mjetet e marra nga donatorët siq është Departamenti i MRKS, Kufizimeve të Klubeve, sponsoret tjerë.

7. Fondi i FPPK

Fondi i bartur me 01.01

Teprica/mungesa e fondit

Gjithësej ekuiteti

	2021	2020
Fondi i bartur me 01.01	41,848.70	(3,520.51)
Teprica/mungesa e fondit	(18,047.64)	45,369.21
Gjithësej ekuiteti	23,801.04	41,848.70

Fondi i përket tepricës pozitive nga periudhat paraprake që ka ndodhë si rezultat i aktiviteve pozitive që ka ushtruar FPPK dhe përfitimet nga donacionet dhe dhuratëdhënësit.

II. PASQYRA E TË ARDHURAVE**8. Donacionet dhe të ardhurat**

	2021	2020
Të Hyrat për projekte	80,139.67	149,113.99
Të hyrat tjera	1,178.80	-
Gjithsej të hyrat	81,318.47	149,113.99

Federata e Pingpongut te Kosovës**Shënimet për pasqyrat financiare, për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor 2021**

Për vitin 2021 Federata ka krijuar të ardhura për shpenzime programore nga hyrjet nga donacionet, kotizime dhe sponsorët në vlerë prej 80,139.67 euro. Hyrjet ju përkasin këtyre donatorëve:

Te hyrat nga kotizimet e klubeve	2,200.00	5,250.00
Te hyrat nga klubet per participim te lojtarve	40.00	1,710.00
Te hyrat nga Departamenti	76,361.00	132,460.00
Te hyra nga KOK	-	700.00
Te hyra nga ankesa në bord te apelit	25.00	-
Te Hyrat nga provimet per refer	120.00	210.00
Te hyra nga Donacione ETTU/ITTF	1,393.67	8,783.99
Te hyrat tjera	1,178.80	-
Gjithsejtë të hyrat:	81,318.47	149,113.99

FPPK, donacionet i ka realizuar për zhvillimin e këtyre aktiviteteve sipas shpalosjes ne shënimet ne vazhdim:

a) Te hyrat nga Departamenti

Të hyrat nga Departamenti në vitin 2021 janë bërë sipas memorandumit të bashkëpunimit për vitin 2021, pra është njohur e hyra në tërësi që ka qenë e paraparë në memorandum në 4 pjesë, e po ashtu edhe aneksi i memorandumit dhe projekti për rimëkëmbje.

b) Të hyrat nga kuotizimet e klubeve

Të hyrat nga kuotizimi i klubeve janë ndarë sipas kategorisë në të cilën konkurrojnë klubet kështu që i kemi këto lloje të hyrash

	2021	2020
Kotizimet e Ekipeve te super liges	800.00	1600.00
Kotizimet e ekipeve U21	00.00	200.00
Kotizimet e ekipeve te liges se pare	1,400.00	1800.00
Kotizimet e ekipeve femrave	0.00	-
Kotizimet e ekipeve te juniorve	0.00	450.00
Gjithsej	2,200.00	4,050.00

c) Të hyra nga Donacionet e ETTU-së – ITTF-it

Federata Europiane e Pingpongut (ETTU) dhe Federata ndërkombtare e Pingpongut (ITTF) gjatë vitit 2021 kanë ndihmuar federatën e Pingpongut me donacion monetar në vlerë 1,393.67 €.

d) Të hyra tjera

Të hyrat tjera kane te bëjnë me te hyrat nga llogaritë e pagueshme të viteve te kaluara 750 euro nga Vllaznimi dhe 428.80 euro nga Deko Solution.

9. Shpenzimet programore dhe operative

Për periudhën nën auditim, FPPK ka pasë shpenzime nga zhvillimi i aktiviteteve të veta në vlerë prej 99,366.11 euro. Politikat e FPPK janë që 40,468.80 euro apo shprehur në përqindje 40.73 % të shpenzimeve të ndodhura t'i klasifikojë për shpenzime programore, ndërsa 27,643.92 apo 27.82 % të shpenzimeve të ndodhura t'i klasifikojë për kompensimet për punë profesionale, 3,705.45 euro apo 3.73%, shpenzime të zyres, 3,250.31 apo 3.27% shpenzime të tjera ndërsa 1,057.63 apo 1.06 % shpenzime të zhvlersimit dhe shpenzime te provizioneve te II. Te arketueshme në vlerë prej 23,240.00 apo 23.39%.

Specifikacioni i shpenzimeve për vitin 2021:

Shpenzimet Programore

PROJEKTET KOMBËTARE

Shpërblimet për lojtarë, trajner dhe klube	12,320.00
Akomodim dhe ushqim	4,074.84
Shpenzime për topa	144.00
Shpenzime për kupa, medlaje për turne	1,161.50
Shpenzime marketing	2,222.20
Shpenzime për javën e sportit	107.00
Shpenzime për ceremoninë e laureatëve	611.80

PROJEKTET NDËRKOMBETARE

ITTF – Shpenzimet për Seminarin e trajnerve Level I	1,308.44
ITTF – Shpenzimet për kampionatin botëror në Huston	1,302.21
ITTF – Shpenzime tjera	54.00
ETTU – Shpenzime të antarsimit për ETTU/ITTF 2021	980.00
ETTU – Shpenzime për kampionatin e seniorve në Poloni	1,864.02
ETTU – Shpenzime për kampin U13 Eurotalens në Mal të zi	596.07
ETTU – Shpenzime për kampionatin U21 në Blegjikë	2,735.85
ETTU - Shpenzime për kampin U17 Eurotalens në Qeki	1,495.96
ETTU - Shpenzime për kualifikimet në Portugali	689.17
BTTU - Shpenzime për kampionatin U15 dhe U19 në Bullgari	6,594.00
KOS-SHQ - Liga e përbashkët	2,207.74
Gjithsej	40,468.80

Shpenzime për kompenzime dhe meditje të personelit

Kompenzim per sekretarin	6,315.83
Kompenzim per zyrtarin e garave	1,169.60
Kompenzim per zyrtarin e mediave	1,656.91
Meditje për Arbiter	2,168.40
Meditje per mbledhje të Bordit	2,385.44
Meditje per gjyqtar të ndeshjeve	6,849.35
Meditje per Komisione të ndryshme	1,193.20
Meditje per lojtar në aktivitete ndërkombtare	1,140.10
Meditje per pergjegjes në aktivtete ndërkombtare	421.08
Meditje per trajner për aktivitete të ndryshme	2,397.71
Meditje për aktivitete të vecanta	491.26
Meditje për teknik	233.92
Meditje për teknik mjeksor	23.39
Kontributet pensionale të punëdhënësit	1,197.73
Gjithsej	27,643.92

Shpenzime të zyres

Furnizime të zyres	76.20
Shpenzim për ushqim dhe pije	798.65
Shpenzime transporti	2,376.80
Shpenzime të IT	428.80
Shpenzime për kthim të pagesës për ankesë në BA	25.00
Gjithsej	3,705.45

Shpenzime tjera operative

Shpenzime të provizionit	697.21
Shpenzime të mirëmbajtjes së webfaqes	111.00
Shpenzime të shpeditimit	1,642.10
Shpenzime të auditimit	800.00
Shpenzimet e provizionimit	23,240.00
Gjithsej	26,490.31

a) Shpenzimet programore

Ju përkasin shpenzimeve të cilat kanë ndodhë për Grantet e pranura nga donatorët siç është Departamenti i sportit të MRKS dhe më detajishtë është shpalosë në shënimin 8 në këtë Raport.

b) Shpenzimet e menaxhimit, administratës dhe pagave

Këto shpenzime kanë ndodhë nga zhvillimi i aktiviteteve operuese të FPPK-së. Pranohen në relacion me destinimin funksional të shpenzimeve te natyrës te mbetur (tepricave) dhe janë prezentuar në Pasqyrën e të ardhurave e cila është pjesë e këtij Raporti.

c) Shpenzimet e zhvlerësimit

Edhe këto shpenzime ju përkasin pasurive të përdorura për zhvillimin e aktiviteteve operuese të FPPK - së. Pranohen në relacion me destinimin funksional të shpenzimeve te natyrës te mbetur (tepricave) dhe janë prezentuar në Pasqyrën e të ardhurave e cila është pjesë e këtij Raporti.

10. Zotimet dhe kontigjencat

Sipas pohimeve të drejtimit, Sekretarit, nuk ka dhënë zotime dhe as nuk pret të ketë detyrime kontigjente.

11. Ngjarjet pas datës së Bilancit

FPPK-së nuk ka prezentuar ndonjë rast që mund të ketë ndikim në Pasqyrat Financiare të datës 31 dhjetor të vitit 2021 deri në përpilimin e këtij raporti.

12. Vijimësia

FPPK, ka hartuar planin operativ për vitin 2022 me më shumë se 75 aktivitete të cilat i ka dorëzuar te Departamenti i Sportit.

Mundësia e vazhimit të aktiviteteve të FPPK edhe për 12 (dymbëdhjetë) muajt e ardhshëm, në bazë të mjeteve të disponueshme, projekteve aktive dhe planeve të drejtimit nuk vihet në dyshim.

13. Aprovimi i pasqyrave financiare

Pasqyra financiare janë aprovuar nga Kuvendi dhe janë autorizuar për publikim më 26.02.2022.